

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Nuk je më babai im"/ Francesco Totti zbulon momentin më të vështirë me vajzën pas ndarjes nga Ilary B lasi
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/nuk-je-me-babai-im-francesco-totti-zbulon-momentin-me-te-veshtire-me-v-i588147
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 15:01:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 15:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1b2d2d58289927fe79509fd4a31c1f24d32a7bbc9f31dc797e35b1da8a6b7af1
TEKSTI	597cfb8b0a95d385491be4c2face647f11631157e40857d5371e46110acd712d
PAMJA	eeaca1b4a0cca70c86bcf13bc8593f0964e97e6f1bcbdc0fafe6fc2e256686fd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cfeb25633cbcb1d8c245e6ee16d8c5d574a0548b90456f92aba73e9ebbcd8089
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c206ef00f3c5688ec3d6505e364edf4e33bce2ceb75a58f689bcce7e176545ba
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cfeb25633cbcb1d8c245e6ee16d8c5d574a0548b90456f92aba73e9ebbcd8089>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie "Puberteti" profesional i Viora Hysenit i kushton Shqipërisë papjekurine institucionale "Nuk je me babai im"/ Francesco Totti zbulon momentin me te veshtire me vajzen fundit

“Nuk je më babai im”/ Francesco Totti zbulon momentin më të vështirë me vajzën pas ndarjes nga Ilary Blasi



24 Shtator 2026, 17:00Lifestyle TEMA



Francesco Totti ka rrëfyer një prej momenteve më të dhimbshme të krizës familjare pas fundit të martesës me Ilary Blasin, duke zbuluar reagimin e vajzës së tij, Chanel, kur ajo mësoi se babai i saj ishte dashuruar me një tjetër grua.

Detajet janë bërë publike në autobiografinë e tij të re, “Oltre”, ku ish-kapiteni i Romës rikthehet te periudha kur marrëdhënia me Ilary Blasin po shkonte drejt fundit dhe vendosi t’u fliste fëmijëve për lidhjen e tij me Noemi Bocchin.

Chanel ishte vetëm 14 vjeçe në atë kohë dhe, sipas rrëfimit të Tottit, e përjetoi shumë rëndë lajmin. Reagimi i saj ishte i menjëhershëm dhe emocional.

“Nuk je më babai im, më neverit”, janë fjalët që Totti kujton se i tha vajza e tij në atë moment. Në versionin e raportuar nga mediat italiane, Chanel përdori edhe një shprehje fyese ndaj të atit, duke shprehur gjithë zemërimin që kishte për situatën.

Pas atij përballimi, marrëdhënia mes tyre u ndërpre për një periudhë të gjatë. Totti tregon se Chanel nuk i foli për rreth nëntë muaj, duke krijuar një distancë të fortë mes babait dhe vajzës.

Por Chanel nuk ishte e vetmja që u përball me vështirësitë e ndarjes së prindërve. Në librin e tij, Totti përshkruan edhe reagimet e dy fëmijëve të tjerë. Cristian, sipas rrëfimit të tij, u mbyll në vetvete, ndërsa Isabel e shprehu dhimbjen përmes lotëve.

Ish-futbollisti tregon se përballja me fëmijët ishte një nga momentet më të vështira të gjithë kësaj periudhe. Ai u përpoq t’u shpjegonte se fundi i marrëdhënies mes dy prindërve nuk nënkuptonte fundin e dashurisë së tyre për fëmijët.

Totti ka rrëfyer se u përpoq t’u përcillte mesazhin se, pavarësisht ndryshimeve në jetën e tij dhe të Ilary Blasis, fëmijët do të mbeteshin gjithmonë njerëzit më të rëndësishëm për të.

Rrëfimi vjen në një prej pjesëve më personale të autobiografisë Oltre, ku Totti flet edhe për periudhën pas tërheqjes nga futbolli, jetën e tij private dhe fillimin e marrëdhënies me Noemi Bocchin. Libri është publikuar më 22 shtator, pak ditë para 50-vjetorit të ish-kapitenit të Romës.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[VIDEO/ Jennifer Lopez “pushton” pasarelat e Milanos](#)

16:15 Lifestyle

London Fashion Week, Elton Ilirjani aty ku nis moda e së ardhmes

15:26 Lifestyle

U ngjit në shtyllën e tensionit të lartë për foto në rrjetet sociale, 12-vjeçarja pëson djegie të rënda

15:26 Lifestyle

[FOTO/ Naomi Campbell shtaqet spektakolare ne Milano, modelja nis nje jete te re larg Londres](#)

14:31 Lifestyle / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.